



**Në  
këtë  
Periodik  
në të lexoni:**

**Raportimi  
i Drejtoreshës së Përgjithshme Ekzekutive  
të AMF-së në Komisionin e Ekonomisë  
dhe Financave**

**Tregu i sigurimeve, janar-shtator 2024**

**Tregu i titujve të Qeverisë jashtë bursës, janar-shtator 2024**

**20 24 VËSHTRIM MBI TREGJET**

**ZHVILLIME TË TJERA**

**7-11**

**INFORMACIONE  
NDËRKOMBËTARE**

**12-15**

## Raportimi i Drejtoreshës së Përgjithshme të AMF-së në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave



Znj. Kaçi theksoi se kjo rregullore shënon një hap të rëndësishëm në tregun e sigurimeve të detyrueshme motorike në Shqipëri.

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi, zhvilloi një seancë dëgjimore në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me miratimin e rregullores "Për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përlllogaritjen e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit".

Gjatë prezantimit, znj. Kaçi theksoi se kjo rregullore shënon një hap të rëndësishëm në tregun e sigurimeve të detyrueshme motorike në Shqipëri. Ajo shpjegoi se rregullorja e re, e cila hyn në fuqi në 1 Janar 2025, sjell risi nëpërmjet sistemit të ri të aplikimit të faktorëve të rrezikut në përcaktimin e primit të sigurimit të detyrueshëm motorik. Në seancë u diskutua mbi ndikimin e faktorëve të rinj të riskut, të cilët përfshijnë historikun e dëmeve, si dhe faktorë të tjerë që lidhen me drejtuesin dhe mjetin.

Primi i sigurimit i diferencuar sipas nivelit të rrezikut, e bën sistemin e tarifimit më të drejtë, më transparent, inkurajon sjellje të kujdesshme nga drejtuesit e automjeteve, parandalon abuzimet si dhe forcon mbrojtjen e konsumatorëve dhe nxit konkurrencën në treg.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar – shtator 2024


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar - shtator 2024 kapën vlerën 18,288 milionë lekë, ose 7.36% më shumë se në janar - shtator 2023. Gjatë muajit janar - shtator 2024, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,177,501 me një rritje prej 7.70% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.92% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.05% dhe risigurimi me 0.039%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.61% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.39% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar - shtator 2024, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,183 milionë lekë, ose 25.71% më shumë se në periudhën janar - shtator 2023.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar - shtator 2024 kapën vlerën 4,549 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 28.68% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Struktura e tregut të sigurimeve, janar – shtator 2024 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar - shtator 2024 arritën rreth 11,043 milionë lekë, ose 7.93 % më shumë se në periudhën janar - shtator 2023.

## Zhvillimet e Tregut të Titujve të Qeverisë jashtë Bursës për periudhën janar - shtator 2024

Të dhënat statistikore të tregut të titujve të Qeverisë jashtë Bursës për periudhën janar - shtator 2024, flasin për një dominim të transaksioneve “Marrje dhe Transmetim urdhri në tregun primar (Ankand)” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 50.64% dhe 36.20% kundrejt vëllimit të përgjithshëm.

Vëllimi i tregut sekondar të titujve të Qeverisë të realizuara jashtë Burse për periudhën janar - shtator 2024, u dominua në masën 60.99% nga transaksione në instrumente afatgjatë (obligacione) dhe 39.01% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari).

Parë nga këndvështrimi i numrit të transaksioneve, 83.94% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, për periudhën janar - shtator 2024 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.16% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

### Tre grupet e transaksioneve B, C dhe F

Transaksioni i llojit B “Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Shitja e titujve të Qeverisë investitorit nga portofoli i bankës, apo shoqërisë komisionere)” gjatë periudhës janar-shtator 2024, ka pasur një rritje prej 3,636 milionë lekë ose 98.98% krahasuar me periudhën janar - shtator 2023. Ndërkohë, numri i transaksioneve i llojit B është ulur në masën 7.59%.

Transaksioni i llojit C “Tregtim për llogari të vet kur ekzekuton urdhrat e klientit (Blerja e titujve të Qeverisë nga banka apo shoqëria komisionere para datës së maturimit nga investitori)” gjatë periudhës janar - shtator 2024, ka pasur një ulje prej 423 milionë lekë ose 17.13%. Numri i transaksioneve është ulur me 17.40% krahasuar me periudhën janar-shtator 2023.

Transaksioni i llojit F “Ekzekutimi i urdhrat të klientit (jo nga dhe për llogari të portofolit të subjektit)”, gjatë periudhës janar - shtator 2024, janë realizuar me vlerë nominale 206 milionë lekë.


Pjesëmarrja në tregun sekondar të titujve të Qeverisë jashtë Burse, për periudhën janar-shtator 2024 dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 98.16% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

## Zhvillimet e Tregut të Titujve të Qeverisë jashtë Bursës për periudhën janar-shtator 2024

(... vijon)

Në totalin e transaksioneve të llojit B, C dhe F të marra së bashku, vihet re një rritje në vlerë absolute me rreth 3,418 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-shtator 2023.

### Tregu i Titujve të Qeverisë jashtë Bursës për periudhën janar - shtator (Në %)



Materiali i plotë i raportit statistikor për periudhën Janar - Shtator 2024 <https://amf.gov.al/news.asp?id=43224>

# ZHVILLIME TË TJERA

## Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, takim me ekspertët e Departamentit Amerikan të Thesarit




Në kuadër të projektit të asistencës teknike nga Departamenti Amerikan i Thesarit, Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi takimin përmbyllës me ekspertët e Zyrës së Asistencës Teknike (OTA), në përfundim të vizitës së tyre dy javore në Shqipëri.

Ekspertët e projektit zhvilluan një sërë takimesh me përfaqësues të Autoritetit, institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor dhe me grupet e tjera të interesit. Fokusi kryesor i këtyre takimeve ishte identifikimi i kompanive me kapital shtetëror dhe bashkive potenciale për nxitjen e emetimit të instrumenteve të borxhit, me qëllim financimin e projekteve të tyre zhvillimore. Kjo iniciativë është në zbatim të Dokumentit Politik "Për Krijimin e një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Shqipëri, 2023-2027".

Znj. Kaçi vlerësoi mbështetjen me asistencë teknike për forcimin e kapaciteteve dhe ekspertizës në nivel lokal, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me synim rritjen dhe zhvillimin e tregut të kapitaleve në vend, në përputhje me strategjinë e Autoritetit dhe politikat qeveritare.

Fokusi kryesor i takimeve ishte identifikimi i kompanive me kapital shtetëror dhe bashkive potenciale për nxitjen e emetimit të instrumenteve të borxhit, me qëllim financimin e projekteve të tyre zhvillimore.

## Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, pjesë e panelit hapës të programit prestigjioz të trajnimit organizuar nga Toronto Center në bashkëpunim me IOSCO



Znj. Kaçi në panel theksoi se "Kalimi drejt metodologjisë me bazë rreziku reflekton angazhimin tonë për përmirësimin e administrimit të rreziqeve, forcimin e mbikëqyrjes së tregjeve dhe qëndrueshmërisë së sistemit financiar, ndërsa ky i fundit bëhet gjithnjë e më shumë dinamik dhe kompleks."

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Mimoza Kaçi, mori pjesë si folëse në panelin hapës të programit prestigjioz të trajnimit "TC-IOSCO Risk Based Supervision for Securities Regulators". Ky event ndërkombëtar organizohet nga Toronto Centre, një institucion global i njohur për programet e forcimit dhe kapaciteteve të rregullatorëve dhe mbikëqyrësve të tregjeve financiare, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), ku Autoriteti është anëtar me të drejta të plota.

Këtë vit, programi që po zhvillohet nga 14-18 tetor, në format virtual, ka si grup të synuar stafin e rregullatorëve nga rajoni dhe më gjerë të përfshirë në mbikëqyrjen e tregjeve të kapitalit. Synimi është të njohë pjesëmarrësit me praktikave më të mira ndërkombëtare për një mbikëqyrje efektive të këtyre tregjeve.

Në panelin me temë "Rregullimi dhe mbikëqyrja e tregut të titujve në rajon - sfida dhe zgjidhje të mundshme", krahas përfaqësuesve të lartë të Autoriteteve homologe nga Gjeorgjia dhe Maqedonia e Veriut, Znj. Kaçi ndau përvojën e AMF-së mbi avantazhet e zbatimit të metodologjisë me bazë rreziku, sfidat e hasura gjatë implementimit dhe adresimin e tyre. "Kalimi drejt metodologjisë me bazë rreziku - u shpreh në fjalën e saj Znj. Kaçi - reflekton angazhimin tonë për përmirësimin e administrimit të rreziqeve, forcimin e mbikëqyrjes së tregjeve dhe qëndrueshmërisë së sistemit financiar, ndërsa ky i fundit bëhet gjithnjë e më shumë dinamik dhe kompleks."

Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare ka qenë çelës suksesi dhe ka luajtur rol kyç në rrugëtimin e Autoritetit drejt kalimit në metodologjinë mbikëqyrëse me bazë rreziku, përmes shkëmbimit të njohurive dhe adoptimit të praktikave më të mira, duke siguruar përafrimin me standartet evropiane të mbikëqyrjes.

## Nënshkruhet marrëveshja për bashkëpunim dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Bordit të Mbikëqyrjes Publike



Marrëveshje synon forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional përmes shkëmbimit të informacionit në fushën e mbikëqyrjes së auditimit ligjor, sigurimin e cilësisë së standardeve të audituesve ligjorë, rezultateve të procesit të kontrollit dhe përmirësimit të nivelit të sigurisë nga auditimet ligjore.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me Bordin e Mbikëqyrjes Publike. Marrëveshja u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, znj. Mimoza Kaçi dhe Kryetari i BMP-së, z. Dritan Fino, në praninë e përfaqësuesve të të dy institucioneve. Kjo marrëveshje ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional përmes shkëmbimit të informacionit në fushën e mbikëqyrjes së auditimit ligjor, lidhur me sigurimin e cilësisë së standardeve të audituesve ligjorë, rezultateve të procesit të kontrollit dhe përmirësimit të nivelit të sigurisë nga auditimet ligjore.

Marrëveshja shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e partneritetit ndërmjet Autoritetit dhe Bordit të Mbikëqyrjes Publike për një mbikëqyrje më efektive të tregut financiar jobankar dhe profesionit të auditimit ligjor, drejt një sistemi financiar të qëndrueshëm, të besueshëm dhe transparent.

## **Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive raporton në Komisionin e Posaçëm Parlamentar të Dezinformimit**



Drejtoresha e Përgjithshme e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Mimoza Kaçi, raportoi më 30 tetor në Komisionin e Posaçëm Parlamentar të Dezinformimit në ambientet e Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë, mbi zbatimin e masave ndaj dezinformimit dhe formave të ndërhyrjes së huaj dashakeqëse në sistemin financiar. Gjatë raportimit, Znj. Kaçi paraqiti shtyllat kryesore ku mbështet puna e Autoritetit në këtë drejtim.

Drejtoresha e Përgjithshme shprehu angazhim të plotë për vijimësinë e bashkëpunimit të ngushtë me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe forcimin e mekanizmave ligjorë dhe të kontrollit për parandalimin e dezinformimit dhe formave të ndërhyrjes së huaj që mund të çënojnë sistemin financiar.

## Workshop për edukimin financiar në tregun e sigurimeve me mbështetjen e Zyrës së Asistencës Teknike, të Departamentit të Thesarit, SHBA



—○○○—  
Diskutimet në workshop u përqendruan edhe në përcaktimin e mekanizmave efikas për rritjen e informimit publik, si edhe dhënien e këshillave për konsumatorët në sigurime, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë rreziqet dhe të zgjedhin mbulimin e duhur të sigurimit.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi një workshop për të rritur edukimin financiar dhe njohuritë për tregun e sigurimeve. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues të shoqërive të sigurimit, broker në sigurime, përfaqësues të organizatave që mbështesin biznesin e vogël, si dhe studentë të degëve të ndryshme. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Autoritetit për Edukim dhe Përfshirje Financiare, me mbështetje të Zyrës së Asistencës Teknike (OTA), të Departamentit të Thesarit të SHBA.

Ekspertja e OTA-s prezantoi në workshop gjetjet dhe rezultatet nga diskutimet e zhvilluara në grupe të vogla të punës, si edhe nga takimet me grupet e interesit, për rritjen e edukimit financiar në Shqipëri. Diskutimet në workshop u përqendruan edhe në përcaktimin e mekanizmave efikas për rritjen e informimit publik, si edhe dhënien e këshillave për konsumatorët në sigurime, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë rreziqet dhe të zgjedhin mbulimin e duhur të sigurimit.

## BULLGARI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave zyrtare nga Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë, FSC, në fund të muajit mars 2024, tregu i sigurimeve në Bullgari arriti në 574.66 milionë euro, me një rënie prej gati 1% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Sigurimet e Jetës përbëjnë 16.9% të portofolit të tregut, rreth 3 pikë përqindje më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimet e Jetës u rrit me 22.5%, në terma vjetore duke arritur në 97.2 milionë euro.

Sigurimet e Jo-Jetës ishin segmenti më i madh që pengoi rritjen e tregut, ku linja e sigurimit MTPL ishte “kontribuesi” më i madh në rënien e tregut. Në përgjithësi, primet e shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës arritën në 477.5 milionë euro, me një rënie prej 4.7% në terma vjetorë. Pesha e klasave të sigurimit motorik në portofolin e tregut u ul në përgjithësi me mbi 3 pikë përqindje, ndërsa pesha e klasës së sigurimeve MTPL në portofolin e tregut ra me gati 8 pikë përqindje. Primet e shkruara bruto për sigurimet MTPL ra me 18.9%, duke arritur në 199.3 milionë euro, ndërsa primet e sigurimit Kasko u rritën me 19.4%, duke arritur në 141.96 milionë euro.

Dëmet e paguara u ulën në përgjithësi me pothuajse 25%, të nxitura nga ulja e ndjeshme e dëmeve të paguara për sigurimet e Jo-Jetës me -33.4%. Në të gjitha linjat e sigurimit të Jo-Jetës, dëmet e paguara arritën në 190 milionë euro.

## GREQI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave të tregut të publikuar nga Shoqata Helenike e Shoqërive të Sigurimeve, HAIC tregu grek i sigurimeve arriti në 2.8 miliardë euro në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2024, me 6.7% më shumë se një vit më parë. Sigurimet e Jo-Jetës u rritën me 8.5% në vit, në 1.44 miliardë euro, ndërsa sigurimet e Jetës, realizuan rreth 1.37 miliardë euro prime të shkruara bruto, duke u rritur me 4.90% në terma vjetore.

Gjatë kësaj periudhe Greqia u përball sërish me fatkeqësitë natyrore dhe sigurimi i pronës pati një rritje të përgjithshme prej 14.77%, duke arritur 300.85 milionë euro. Në vitin 2024, siguresit i janë përgjigjur rritjes së shpeshtë të zjarreve, tërmeteve dhe përmbytjeve që ndikuan vendin vitin e kaluar, duke prezantuar ose përmirësuar produkte të dizajnuara për të ofruar mbrojtje kundër fatkeqësive natyrore.

Nga rreth 6.17 milionë shtëpi të regjistruara në Greqi, vetëm rreth 1 milion janë të siguruar privatisht. Për të rritur marrjen e sigurimeve, qeveria greke ka prezantuar një sërë masash që synojnë rritjen e mbulimit të sigurimit të pronës, duke përfshirë ofrimin e stimujve fiskalë për pronarët e shtëpive dhe detyrimin e sigurimit për disa kategori të ndërtesave dhe automjeteve të korporatave.

## KROACI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare, HANFA, në fund të shtatorit 2024 primi total i mbledhur nga siguruesit vendas arriti në 1.43 miliardë euro, nga të cilat 0.25 miliardë euro ishin prime në sigurimin e Jetës dhe 1.18 miliardë euro ishin prime në sigurimin e Jo-Jetës.

Struktura e primit të arkëtuar në sigurimin e Jo-Jetës dominohet nga sigurimi i përgjegjësive së mjeteve motorike me 30.7% e totalit të primeve të shkruara bruto të tregut, i ndjekur nga primet në sigurimet mjeteve tokësore me 15.5% dhe sigurimi i pasurisë me 15.17%. Në sigurimin e pasurisë, sigurimi ndaj zjarrit dhe fatkeqësive natyrore dhe sigurimet nga dëmtimet në pronë kanë kontribuar pothuajse në pjesë të barabarta.

Shuma e paguar për dëmet e shlyera në nëntë muajt e parë të 2024 arriti në 924.43 milionë euro. Nga kjo shumë 337.85 milionë euro janë të lidhura me sigurimet e Jetës, ndërsa 586.6 milionë euro lidhen me sigurimet e Jo-Jetës.

Në shumën totale të dëmeve të paguara në sigurimet e Jo-Jetës, shumat më të mëdha kanë të bëjnë me sigurimin e përgjegjësive nga automjetet (40.37%), sigurimin e automjeteve tokësore (21.92%) dhe sigurimin e pasurisë (17.63%).

## MALI I ZI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në fund të shtatorit 2024, tregu i sigurimeve në Malin e Zi arriti në 102.6 milionë euro, 12.7% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sipas të dhënave tremujore të tregut të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Malin e Zi, vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit arriti në 42.64 milionë euro, me 22.84% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Siguruesit e Jetës gjeneruan rreth 18.82% të totalit të tregut të sigurimeve ose 19.3 milionë euro, me një rritje prej 21.92% në terma vjetorë, ndërsa segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës arriti në 83.27 milionë euro, kundrejt 75.15 milionë euro një vit më parë.

Dy linjat e biznesit të Jo-Jetës, Prona dhe sigurimi Motorik, ishin nxitësit kryesorë të rritjes së vëllimit të primeve të shkruara bruto si edhe të dëmeve të paguara.

## POLONI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në gjysmën e parë të vitit 2024, siguruesit polakë realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 9.93 miliardë euro duke shënuar një rritje prej 13.8% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë, me rritje në pothuajse të gjitha linjat e biznesit. Dëmet e paguara arritën në 5.55 miliardë euro, 13% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rezultatet e shprehura në euro duken më të mira për shkak të vlerësimit të lehtë vjetor të monedhë vendase, zloty kundrejt euros. Në monedhën kombëtare tregu u rrit me 9.9%, ndërsa dëmet e paguara u rritën me 9.6%.

Vëllim të primeve të shkruara bruto në sigurimit e Jetës u rrit me 7.96% në terma vjetore, duke arritur në 2.73 miliardë euro. Sipas Dhomës Polake të Sigurimeve, në fund të qershor 2024, 11.2 milionë polakë kishin polica individuale të sigurimit të Jetës, ndërsa 11.8 milionë të tjerë ishin të siguruar në sigurimet në grup. Pagesat kanë vazhduar të ulen, duke reflektuar rënien e vdekshmërisë pas pandemisë.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimit e Jo-Jetës u rrit me 15.6% në terma vjetore, duke arritur në 7.2 miliardë euro. E shprehur në monedhën vendase kjo rritje ishte 12.01%. Dëmtimet e paguara për sigurimet e Jo-Jetës u rritën me ritëm më të lartë, 22%, duke arritur në 3.68 miliardë euro.

Gjysma e parë e vitit ishte e pasur me ngjarje intensive të motit (stuhitë, ngrica, breshër, erëra, shira të rrëmbyeshëm), por edhe me humbje të shkaktuara nga zjarret. Pjesa më e madhe e dëmeve kanë qenë lokale, por vlera e tyre po rritet sistematikisht. Ndërkohë që vëllimi i primeve për sigurimin e pronës u rrit me 19.3%, duke arritur në 1.46 miliardë euro, pati një rritje prej 34.8% të dëmeve të paguara, duke arritur në 549 milionë euro.

Sigurimet motorike ruajtën peshën e tyre në portofolin e tregut, me një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 1.6 miliardë euro për sigurimin Kasko dhe 1.98 miliardë euro për sigurimin MTPL. Dy këto linja biznesi përbënin gjithashtu pjesën më të madhe të dëmeve të paguara në sigurimet e Jo-Jetës, me 63%.

Primi mesatar i sigurimit MTPL aktualisht ka arritur në 531 PLN, ose 5.3% më shumë krahasuar me një vit më parë. Në të njëjtën kohë, edhe vlera e dëmit mesatar të kërkuar u rrit me 10.2%.

## SERBI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave të publikuara nga Banka Kombëtare e Serbisë, siguruesit serbë e mbyllën tremujorin e parë 2024 me një vëllim të primeve të shkruara bruto totale me vlerë 41.69 miliardë RSD rreth 355.96 milionë euro, që është 16% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Tregu dominohet nga sigurimet e Jo-Jetës, të cilat gjenerojnë 82% të të gjitha primeve. Klasat më të mëdha të Jo-Jetës si MTPL, dëmtime në pronë, sigurime shëndetësore, sigurimi Kasko, të gjitha shënuan rritje vjetore. Sigurimi i Jetës ka shënuar një rritje vjetore shumë të lehtë prej 2% dhe pesha e tij në portofolin e tregut ka rënë në 17.70%.

Totali i dëmeve të paguara u rrit me 18.42% duke arritur në rreth 160.70 milionë euro, e nxitur dhe nga rritjet e raportuara pothuajse në të gjitha nënklasat e sigurimeve të Jo-Jetës. Dëmtimet e paguara nga sigurimet motorike u rritën me gati 24%, ndërsa në sigurimin e pronës kompanitë paguanin 28.44% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

## SLLOVENI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu sloven i sigurimeve pësoi një rënie me 10.37% në gjysmën e parë të 2024, duke arritur një vëllim të primeve të shkruara bruto në 1.45 miliardë euro. Primet e shkruara bruto në sigurimet e Jetës u rrit me 8.2%, duke arritur në 444.27 milionë euro. Pjesa më e madhe e rritjes vjen nga linjat tradicionale të sigurimit të Jetës me 60.65 milionë euro, ndërsa linja e produkteve të lidhura me skemat e investimeve, Unit-Linked, realizuan rreth 18 milionë euro.

Sigurimet e Jo-Jetës u ulën me 16.7%, duke arritur në 1.006 miliardë euro. Kjo erdhi si pasojë e reagimit ndaj vendimit të qeverisë, që duke filluar nga 1 janari 2024 të heqë sigurimin shëndetësor suplementar vullnetar dhe ta zëvendësojë atë me një kontribut shëndetësor të detyrueshëm të menaxhuar nga Instituti i Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë, një organizëm publik.

Pas heqjes së sigurimit shëndetësor suplementar, kompanitë slovene të sigurimeve u përballën me një sfidë se si të dizajnonin produkte të reja të sigurimit shëndetësor dhe të riorganizonin një sektor të tërë biznesi. Ky ndryshim legjislativ krijoi sfida të shumta për siguresit e specializuar, ai gjithashtu solli një përfitim të përkohshëm. Heqja e një vëllimi të konsiderueshëm të shpenzimeve për dëme, për shkak të anulimit të shumë policave të sigurimit shëndetësor, çoi në një përmirësim të përkohshëm të përfitueshmërisë.

Në sigurimin e pronës, vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit me 15.6%, duke arritur në 235.6 milionë euro. Linjat e sigurimeve motorike patën, në terma absolutë, kontributin më të lartë pozitiv në prime. Në përgjithësi, primet e shkruara bruto në sigurimin motorik arritën në 515.9 milionë euro.



Për informacion të mëtejshëm  
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)